

E në cilin grup jeni ju?

Në esencë qëllimi im i vërtetë gjatë përpilimit të shkrimit vijues është përrurimi i vëllezërve tanë muslimane, si zgjedhës ashtu edhe të zgjedhur, për sukseset e treguara gjatë respektimit të rregullave logjike dhe përcaktimeve fetare Islame me rastin e emërimit të prijësit të ri fetar.

Duke e shkruajtur këtë urim isha i përmbushur me shpresa të ndryhme. Kështu që shpresoja se B.I, për dallim nga e kalura, do të mundohet të vepron sa më tepër në përputhje me normat Islame dhe me nevojat bashkohore të një institucioni modern. Poashtu shpresoja ardhjen e një Reisi me reprezentativitet dhe shkallë akademike përkatëse, i cili për dallim nga udhëheqësit e kaluar, do të vendoste personat kompetent në pozitat me kërkesa të larta akademike e profesionale. Shpresoja në ardhjen e një Reisi, i cili nuk do ta trajtonte B.I si pronë atërore e nuk do ti përqëndronte të gjitha përpjekjet e tij në okupimin e posteve kyçe me rrethin e tij fshatar apo familjar. Po ashtu kisha besuar sinqerisht se ndoshta për herë të parë në jetën e tyre hoxha "efenditë" tanë, duke nxjerrur mësim nga sirtari i pasur i gabimeve të tyre të kaluara, do të vepronin më drejtë e guximshëm.

Shpresoja poashtu se hoxhallarët tanë tani vecmë kishin kuptuar se brezi i të rive nuk do të kish toleruar një prijës pseudo-akademik që posedon krye të larë me ideologji të fosilizuara politike, i cili në cdo aspekt është inferior ndaj tyre. Me fjalë tjera, kisha shpresuar se të gjithë janë të bindjes se periudha e udhëheqjes së B.I me metoda timaro-spahike nga dora e një Reisi me qëndrime derebejlerësh, ka mbetur në të kaluarën. Mirëpo së pari rrjedha e zgjedhjeve e më vonë rezultati përfundimtar i tyre fatkeqësisht më vërtetuan se shpresat e mësipërme nuk qenkan asgjë tjetër pos iluzionesh. Siq shihet periudha aq e pritur reformuese edhe një herë u nëpërkëmb për hirë të interesave të ngushta personale e u shty për një kohë të pacaktuar. Them u shty, ngase bindja ime në realizimin e saj është e patundshme.

Andaj, shkrimi im përrurues akoma në fazën e sajimit të saj u shëndrua papritmas në një problem, edhe atë në një problem të komplikuar dhe vetëkundërshtues si përrurimi i dicka të porealizuar. Po të thoja se nuk u dëshpërova nga një gjendje e këtillë, do të kisha trilluar një gënjeshtër vëllimisht të barazvlefshme me atë të zgjedhjeve. Mirëpo dëshprimi im nuk buronte aq shume nga zgjedhja apo më saktësisht moszgjedhja e Reisit sa nga rrjedha e mëtejshme e ngjarjeve. Cka të bëja unë tani? Cfarë qëndrimi të merrja përballë "zgjedhjeve" të këtilla, të cilat jo vetëm që na lanë pa një Reis të vërtetë, por edhe një herë i luhatën besimet tona në vlerat si përparim dhe drejtësi. Pyetjet e lartpërmendura mu ngulitën në krye në një mënyrë të pazakontë për mua. Nën tryshnië e tyre, por pak edhe si zakonshëm vendosa të botoj një shkresë, ku do të vija në dukje paaftësinë e Reisit e do të mbroja mendimin se kemi vëllezër tjerë, të aftë që të na udhëheqin sipas kërkesave të fesë Islame dhe kohës. Megjithate, pasi mu dha rasti të bisedoj me disa njohës të Reisit mu bë e qartë se diçka e këtillë (pra, dëshmia se personi në fjalë nuk e meriton këtë post) do të ishte poaq e panevojshme dhe kundërshtuese si përpjekja për të vërtetuar se dielli ndriçon. Me fjalë tjera, nuk takova ndonjë kundërshtues të tezës së pamjaftueshmërisë së Reisit që ta vërtetoja të kundërtën. Mirëpo, njëherë vecmë kisha vendosur të shkruaj diçka. Në këtë rast mu paraqitën vetëm tre mundësi:

- Ose do ta përfundoja dhe dërgoja përrurimin tim, pavarësisht nga të gjitha çrregullsitë e paraqitura.
- Ose duke qenë plotësisht i vetëdëshëm për urgjencën e situatës do të heshtja e do ti varrosja mendimet e mia në vete.

· Ose do të mbaroheja prej vetes e përrurimin tim do ta shëndroja në një shkrim kritikues, pa i marrë parasysh rrjedhimet e mundshme. Natyrisht isha i vetëdëshëm se në të ardhmen secili nga opsionet e lartpërmendura do të kishte pasoja të ndryshme për mua (e posaqërishtë opsioni i tret). Njëkohësisht, shikuar nga këndvështrimi i filozofisë makiaveliste, me këtë akt do të bëja një "gabim" të rëndë politik dhe strategjik si kundërshtimi i të fortëve dhe pushtetmbajtësve e jo përkrahja e tyre. Sido që të jetë, këto gjëra nuk më shqetsonin dot. Dhe përveç kësaj unë nuk do të isha as i pari e as i fundit, i cili do ti mbante konsekuencat. Në fund të fundit historia e "lavdishme" e dakadës së fundit të B.I është e plotë me dënime të pashoqe. Përfundimisht, mendova se më e drejta do të ishte që ta bëj një ekskurs të mundësive të ndryshme, përpara se të vendosem për më të qëlluarën.

1) Ata, që i dërguan përrurimet, perkundër gjithë çrregullsive të ndodhura Sipas analizave të mia sjelljet e hoxhallarëve dhe vëllezërve tanë nga ky grup u gjasojnë mjaftë sjelljeve të atyre, të cilët në filozofi emërohen si "mospërfillës të ekzistencës së Zotit". Këta edhe pse nuk e kundërshtojnë ekzistencën e Zotit, pothuaj në të gjitha veprimet e tyre sillen sikur Ai të mos ekzistonte fare. Në rastin tonë konkret këta personë përrpiqen ti shpikin rregullat e tyre të zgjidhjes së prijesit, sikur në Kur'an, Hadis dhe në zbatimet e As'habëve nuk ka udhëzime mbi ate, se kush bëhet Reis dhe si zgjidhet ai, kujt i propozohet kandidimi e kujt i jepet përparësi. Kuptohet, këta kritere artificiale, duke mos qenë fare të paqëllimta janë natyrisht të ndërlydhura ngushtë me interese të indeksuara në të ashtuquajturin "materializëm të thjeshtë personal".

Siç kemi lexuar edhe në shkrimet e kaluara, në krye të këtyre interesave qëndrojnë perpjekjet e personëve në pozita të pamerituara në B.I që tu dalin zot të njejtave. Pranimi i një rroge më të majme dhe përjetimi i krenarisë së zgjedhjes së Reisit dhe mburrja me këtë bëjnë gjithashtu në tërësinë e interesave të lartpërmendura. Njerëzit e kësaj dore nuk zgjedhin prijes, ata vetëm kujdesen që ti mbrojnë interesat vetjake. Dhe duke vepruar kështu, atyre nuk u shkakton pikë brengë dëmi që ia bëjnë popullit në këtë dhe vetes në botën tjetër. Shkurtimisht, ky lloj njerëzish nuk qëndron pas kandidatit të goditur, por pas atij të fortë edhe ate pa zgjedhur mjete për ta siguruar fitoren. E për ti kënaqur zemrat e tyre të mjera, të përvëlura me interese të thjeshta, përrpiqen që të duartrokisin me gjithë shpirt çdo veprim të Reisit, pa e shoshitur fare rregullsinë e veprimeve të tij. Pra, siç shihet, kemi të bëjmë më një grumbull palaçosh.

Pjesëtarët e këtij grupi, të cilët jo vetëm që më dhimbsen më tepër, por edhe ma shkaktojnë dhimbjen më të madhe janë ata me karrierë akademike, në njohuritë dhe dijeninë e të cilëve besoja sinqerisht. Personë, të cilët deri dje shiteshin si njerëz të çështjes, e sot presin ti pranojnë apo veçmë i pranuanë postet në një sistem, të cilin deri dje e kritikonin. Zemrën time ma trazoi më së shumti kthimi i këtyre njerëzve në momentin e fundit, edhe ate me një kthim për përrshkrimin e të cilit 1800 nuk mjaftojnë dot. Shkaku i këtij kthimi nuk më është i njohur, mirëpo nuk do të dëshiroja të besoj se ashtu si përrflitet, ai përrbëhet vetëm nga dëshira për post. Pasi sipas meje ky është me të vërtetë njëri nga synimet më padinjitoze. Një akademik i mirëfilltë do të kish parapëlqyer ta flijojë jetën në vend që të bëjë diçka të kërtillë, një veprim, shembujt e të cilit nuk kanë munguar në historinë e lavdishme Islame (të kujtojmë vetëm rastin e Ebu Hanifes, i cili pas refuzimit të një posti të lartë syrgjynoset në burg, ku edhe e humb jetën). "Vëllezërit" tanë, pjesëtarë të grupit në fjalë, janë bartës kryesorë të përrgjegjësisë për gjendjen prezente. Derisa "vëllezër" të kërtillë mbajnë poste të larta, përrparimi nuk do të ishte diç tjetër pos një dëshire utopike.

2) Ata, të cilët edhe pse të vetëdëshëm për ngutshmërinë e situatës, mbetën pa reaksion. Vëllezërit e ndershëm, pjesëtarë të këtij grupi, janë bukur të vetëdëshëm se gjendja prezente nuk përrputhet as me normat Islame e as me ato të logjikës së shëndoshë. Po të merret parasysh ky fakt del se ky grup nuk është më pak përrgjegjës për padrejtësitë e kryera se grupi i parë. Këta janë të ndikuar tërrthorazi nga vetë paraqitja e padrejtësive e drejtpërdrejtë nga vazhdimi i tyre. Gabimin më të madh të këtij grupi e përrbën heshtja përrballë padrejtësive dhe të keqit. Megjithëse vetëdija e lartpërrmendur përrmban

mundësinë e fshehur e të munguarit të disa anëtarë të grupit të parë (gjë që bile mund të trajtohet si rrethanë lehtësuese), ajo luan rol qenësor të grupi i dytë. Këta shokë janë patjetër të vetëdijshëm për padrejtësitë prezente dhe në një mënyrë ata bile edhe protestojnë kundër këtyre të fundit. Mirëpo, pasi ky protest ngjan pas dyerve të mbyllura, ai nuk e shkakton dot jehonën e duhur. Vallë, cka u duhet thënë shokëve të dashur dhe të nderuar, të cilët edhe pse i vërejnë të gjitha këta gjëra, nuk ndërmarrin asgjë për ndryshimin e tyre? Sipas meje më të mirën ua thotë i Dërguari (a.s.) vetë: "Kur të ballafaqoheni me një të keqe, atëherë përpikuni ta mënjanoni me duar (fuqi), nëse nuk u mjafton forca, atëherë provoni me gojë, e nëse dështoni edhe me këtë, atëherë lutuni, mirëpo në këtë rast keni besim të dobët."

Ndërgjegjes së këtyre vëllezërve, si përbërës të grupit qëndror, dëshiroj t'u drejtoj një thirrje nga thellësia e zemrës sime:

O "shumicë e heshtur":

- Deri kur do të vazhdojmë vetëm të lutemi, duke jetuar nën trysinë e të qenit besimdobët?
- Nëse ne, njerëz të besimit dhe përveç kësaj edhe prijës fetarë, nuk mund të ndryshojmë diçka me forcë, ku janë fjalët dhe shkresat tona?
- Deri kur do ta durojmë përcaktimin e fatit tonë nga personët e grupit të parë?
- Poqëse vazhdojmë të mbesim kështu të pazë, kush do të vërtetojë se ne, qoftë edhe tërthorazi, nuk jemi pionë të ngjarjeve?
- Objektivisht shikuar, si mund të vlersohet kjo heshtje e jonë si ndihmë apo pengesë kundër përpjekjeve për menjanimin e padrejtësive ?
- Si do t'ua sqarojmë këto ngjarje brezërave të ardhshëm ?
- Si do të jetë reagimi ynë, kur të ballafaqohemi me pyetjen se çka kemi bërë në këto kohëra padrejtësisht?
- Si do t'ua shpagojmë hakun atyre, që në reagimin e tyre kanë mbetur të vetmuar?
- Dhe përfundimisht, si do të përgjigjemi para Allahut për neglizhencën tonë ndaj padrejtësive të ngjara akoma para syve tanë?

Në qoftë se mund të mbeteni të qetë përpara të gjithë këtyre pyetjeve, atëherë nuk do të kisha diç për tu thënë, mirëpo nëse këto pyetje ua shqetësojnë ndërgjegjen atëherë do tu kisha përkujtuar se koha e të reaguarit tashmë ka ardhur e po kalon.

Përveç kësaj do të kisha edhe nja dy gjëra për të shtuar:

A) Fatkeqësisht edhe unë isha në këtë grupë deri tani. Por me kohë mu bë e qartë se për mua nuk ka vend këtu. Më vjen me të vërtetë keq që deri sot kam qenë pjesëtar i këtij grupi. Mirëpo unë nuk e qetësoj vetëdijen time vetëm duke shprehur keqardhje, por kaloj në grupin e reaguesve, i cili do të diskutohet më tej, në mënyrë që me të gjitha mjetet të përpikem mos ti lë ata të vetmuar. Ngase tashmë ka kaluar koha e fjalëve boshe e ka ardhur çasti i shpagimit të haqëve të grabitura.

B) Ajo që u tha mbi këtë grupë nuk përmban asesi një thirrje apo fetva për mëkëmbje kundër Reisit të ri. Kjo edhe nuk është mënyra e të vepruarit tim apo të bashkëmenduesve të mi (metoda e të emëruarit të njerëzve me attribute të rënda si murdet apo munafik i përket B.I.'së viteve të fundit). Qëllimi im fillestar ishte paralajmërimi i atyre, që e kuptojnë ngutshmërinë e situatës, ta shprehin reaksionin e

tyre. Këtyre vëllezërve të vetëdëshëm do të dëshiroja t'ua tërheq vëmendjen për faktin se shfaqja e vërtetë e vetëdijes ndodh vetëm në vepra, do të thotë, të qenit i vetëdëshëm për padrejtësinë nuk është e mjaftueshme, thelbësorja është shprehja e mendimeve. Me fjalë tjera, qëllimi im ishte vetëm aktualizimi i një potenciali ekzistues, se dhënia e potencialit nuk i takon kujt tjetër pos Allahut.

C) Të mëkëmburit, të cilët nga frika ndaj Allahut dhe duke u mbaruar prej vetes u ndien të shtrënguar ta ngritin zërin e protestës, pa i patur parasysh rrjedhimet e mundshme

Më besoni, ky ishte grupi, mbi të cilin do të dëshiroja më së shumti të shkruaj. Mirëpo numri i pjesëtarëve të tij është aq i vogël... Sikur këta vëllezër të ishin në numër poaq sa ata të grupeve tjera, jam i sigurtë se gjendja e sotme do të ishte krejtësisht e ndryshme ashtuqë unë në vend të këtij shkrimi, me të vërtetë do të dërgoja një përrurim.

Megjithatë, nuk ka kuptim fare që të dëshprohemi, ngase ky grup duket i vogël vetëm kur të krahasohet me të përgjithshmen apo idealen. Përndryshe, shikuar në pikëpamje cilësore po edhe për nga tendenca e zhvillimit, ky grup vijon një trend, i cili dita ditës vjen duke u përmirësuar. Dhe ai duhet medoemos përmirësuar, pasi pa u ndryshuar ne, gjendja jonë edhe më pak ndryshon.

Pas kësaj analize të gjatë dalin në shesh (së paku për mua) disa pika të rëndësishme, të cilat do të dëshiroja t'ua rendis:

- Gabimin nuk duhet kërkuar te i Zgjedhuri, por te zgjedhësit. Se në ditën e sotme nuk do të ishte e realltë të presim që një njeri i propozuar për postin e Reisit të ngritet e thotë: "Jo, unë nuk e meritoj këtë".

- Ata, të cilët në secilin rast kur janë në pyetje interesat e tyre veprojnë e zgjedhin pa i përfillur fare rregullat Islame, nuk përmirësohen kurrë. Gabimi jonë më i madh do të ishte që të përpiqemi t'ua tregojmë rrugën e drejtë, duke shpresuar se një ditë këta do të bashkëpunojnë sinqerisht me ne. Herët a vonë këta i kthehen turmës së tyre. Këta duhen medoemos mënjanuar.

- Ata, që janë të vetëdëshëm për padrejtësinë, duhen prishur heshtjen e tyre dhe çkado që ti kushtojë, duhen ngritur zërin e tyre të protestës në përputhje me përcaktimet Islame. Jo, në rast se nuk e bëjnë këtë, atëherë le të mos bisedojnë pas dyerve të mbyllura në mënyra që nuk i përngjasin një muslimani, por le të heshtin dhe le ta pranojnë Reisin e ri, pa marrë parasysh personalitetin e tij. Mundësi të tretë nuk ka. Ose kundërshtoni duke reaguuar, ose heshtni dhe pranoni.

Unë e ngrej zërin tim të protestës kundër këtyre padrejtësive dhe përpiqem ta shfaq reaksionin tim përmes këtij shkrimi.

Falemnderimi dhe lavdia i takojnë Allahut, i cili pas një kohe të gjatë të kaluar në grupin e dytë, më mundësoi të kaloj në grupin e tretë.

E ju.... Në cilin grup jeni ju?

Zekerija Sejdini